



www.lezha.gov.al

# bashkia ime

Botim i Bashkisë Lezhë, Nr. 7, janar 2018



## Finalizohet ujësjellësi i ri i Lezhës, Shëngjinit dhe Balldrenit



Empowered lives. Resilient nations.



Integrimi i komunitetit RE, fq 5

Buxhetin Afatmesëm 2018-2020 fq 6


Një pemë më shumë, fq 15

THIRRJE PËR PROJEKTE, fq 18



**Redaksia**

Drejtoria e Integrimit në BE dhe Programeve të Zhvillimit  
Lajmet: Altin Mema, Rrok Lelçaj, Gjergj Figuri  
Fotot: Olsi Tetaj  
Redaktorë: Hekuran Koka, Xhulia Lekaj  
Design: Hekuran Koka, Evaristo Coli  
www.lezha.gov.al, pzhvillimi@lezha.gov.al



**Në Lezhën e Pjetër Zarishit, Fishtës, Hafiz Ali Ulqinakut, At Zef Pllumit e Ndoc Gjetjes në përgatitje të përkujtimit të 17 Janarit - 550 vjetorit të vdekjes së Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti-Skenderbeu.**


Finalizohet me sukses Ujësja e Lezhës	4
Integrimi i komunitetit RE	5
Mbi Buxhetin Afatmesëm për vitet 2018-2020.	6
Mblidhet Këshilli Bashkiak i Lezhës	7
Mblidhet Shtabi i Emergjencave Civile	7
Përurohet Shkolla e mesme “Gjovalin Gjadri”	10
Bashkia Lezhë ka edhe sivjet praktikën më të mirë	11
Kartolina e fëmijëve me aftësi ndryshe	12
Shpërndahen ndihma për familjet në nevojë	13
Fund dhunës ndaj grave dhe vajzave	14
Një pemë më shumë	15
Koncert festiv në prag të Vitit të Ri	16
Futbollisti Nikolin Lorenci “Qytetar Nderi”	17
THIRRJE PËR PROJEKTE	18

# Finalizohet me sukses projekti i furnizimit me ujë të pijshëm për Bashkinë Lezhë dhe Njësitë Administrative Shëngjin e Balldre

Bashkia Lezhë ka finalizuar me sukses implementimin e projektit të furnizimit me ujë të pijshëm të qytetit të Lezhës dhe Njësitë Administrative Shëngjin dhe Balldre. Kryebashkiaku Fran Frrokaj, në takim që pati me financuesit e projektit vlerësoi kontributin e tyre që ka zgjidhur një problem të shumë viteve për mijëra banorë. Frrokaj, gjatë diskutimeve u ndal edhe te projekte të tjera konkrete në të cilat mund të bashkëpunohet, ku pala zvicerane që kryesohej nga Shefi i Misionit të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri z.Philipp Keller dhe Drejtori i Bankës Gjermane në Shqipëri z.Bjorn Thies, shprehën mbështetje në realizimin e investimeve të tjera që lidhen me shmangien e përmbytjeve. Keller dhe Thies, vlerësuan punën e bërë deri më tani. Ata vlerësuan korrektesën e Bashkisë Lezhë dhe Ndërmarrjes së Ujësjellësit në realizimin e këtij investimi të dobishëm që ka të bëjë



me furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë pa ndërprerje për qytetarët. Suksesi i këtij projekti, i cili është model në të gjithë Shqipërinë, hap rrugën drejt financimeve të tjera që iu vijnë në ndihmë banorëve të Lezhës, nënvizuan financues të shtetit Zviceran dhe atij Gjerman. Frrokaj ka shoqëruar donatorët në kqyrjen nga afër të terrenit të furnizimit me ujë të pijshëm, ku depot e reja në qytetin e Lezhës, në Njësinë Administrative Shëngjin dhe Balldre, si dhe i gjithë sistemi i shpërndarjes së ujit kontrollohet online nga Ndërmarrja e Ujësjellësit. Kryetari i Bashkisë Lezhë, në fund të takimit u shpreh i sigurtë së Banka Gjermane për Zhvillim, Banka Zvicerane apo çdo investitor tjetër do të gjejnë bashkëpunimin e frytshëm të institucionit që drejton për të shtrirë bashkëpunimin në realizimin e projekteve të tjera që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.



# Integrimi i komunitetit Rom & Egjiptian të Lezhës, në vëmendje kombëtare

Bashkia Lezhë sëbashku me fondacionin Create dhe me mbështetjen e programit të qeverisë Zviceriane, DLDP, organizoi konferencën e donatorëve në kuadër të përmirësimit të gjendjes së komuniteteve Rom dhe Egjiptian, sfidat dhe integrimin e tyre në Bashkinë Lezhë. Në këtë takim morën pjesë krahas drejtuesve vendorë, përfaqësi diplomatike të akredituara në Shqipëri, deputetët e Lezhës, znj.Lindita Metaliaj dhe Pjerin Ndreu, drejtues organizatash, shoqatash, bankave të nivelit të dytë etj. Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi mes të gjitha palëve në përmirësimin e kushteve të jetesës, arsimimin dhe integrimin e tyre. Kryetari i Bashkisë Lezhë z.Fran Frrokaj pasi vlerësoi këtë organizim bëri një analizë të përpjekjeve gjatë këtyre dy viteve në mbështetje të këtyre familjeve.

Frrokaj tha se Bashkia Lezhë ka mundësuar:

1. Ndërtimin e 8 banesave sociale për familjet rome dhe egjiptiane
2. Përshtatjen e ambjenteve në zonën industriale për banim për 12 familje rome dhe egjiptiane
3. Pagesën e qerasë për banim për 34 familje rome dhe egjiptiane.
4. Ndihmë ekonomike dhe përkujdesje sociale për këtë komunitet nga Drejtoria e Shërbimit Social.
5. Me financimin e Urdhërit të Maltës, të kishës Katolike me qendër në Shkodër, është ndërtuar dhe ka filluar funksionimin për një periudhë 10-vjeçare qendra multifunksionale për mbështetjen e fëmijëve, rinisë dhe moshës së tretë të këtij komuniteti në lagjen Skënderbeg. Në këtë takim u bë edhe prezantimi fillestar i një projekti të studiuar mes Bashkisë Lezhë dhe "Create Fondation - Prishtinë", që parasheh ndërtimin e banesave për komunitetet në fjalë, shkollimin,

ushyerjen etj. Pas këtij prezantimi, Frrokaj, në prani të përfaqësuesve të qeverisë, agjensive të zhvillimit, ambasadave, OJF-ve dhe përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian, kryebashkiaku bëri apel që të rritet sensibiliteti dhe të punojmë për zgjidhje dhe jo shtyrje të tyre. Bashkia Lezhë do të kthejë në projekte konkrete gjetjet e këtij studimi për të nisur dialogun me qeverinë dhe donatorët për financimin e tyre që çojnë në integrimin e familjeve rome dhe egjiptiane, nënvizoi më tej Frrokaj. Në Bashkinë Lezhë jetojnë rreth 450 familje të këtij komuniteti, ndaj dhe politikat sociale ndaj tyre kërkojnë bashkëpunim, bashkëpunim për të cilin apeloj në këtë takim edhe Ambasadori i Çekisë, z.Jaroslav Ludva. E përshëndetën këtë konferencë edhe përfaqësues të komuniteteve rom dhe egjiptian, të cilët duke falenderuar Bashkinë për punën e bërë deri tani në drejtim të strehimit e përmirësimit të kushteve të jetesës parashtruan për donatorët nevoja e kërkesa të tjera të mundshme për t'u realizuar.



# Mbi procesin e përgatitjes së Buxhetit Afatmesëm të Bashkisë për vitet 2018-2020.

Mbas reformës territoriale Bashkia operon në një territor më të gjerë, pra, vendosja e një ekuilibri eficient dhe të qëndrueshëm mes tyre kërkoi një vizion të qartë të bazuar në njohje kapilare të territorit, me mbështetje e kontribut aktiv dhe të vazhdueshëm nga institucionet vendore, qytetarët, bizneset, shoqëria civile, planifikuesit, etj.

Është pikërisht Strategjia e Zhvillimit të Territorit të Lezhës, e cila tashme e përfunduar, që shihet si lexim e mirëkuptim i kësaj shumëllojshmërie. Ky dokument i integruar dhe dokumentat e tjera strategjike, i shërbyen edhe procesit të planifikimit të PBA 2018-2020 dhe buxhetit të vitit 2018. Pra, Bashkia Lezhë, në procesin e planifikimit dhe përfitimeve të komunitetit, nuk shikohet si një bashkësi prej dhjetë një-sish administrative, por si një organizëm i vetëm ku çdo zonë ose grup banorësh kanë të njëjtat raporte me territorin dhe me administratën vendore.

Vizioni i Bashkisë Lezhë synon të bëhet:

I. Platformë turizmi dhe shkëmbimi tregtar, e kompletuar me logjistikë mbështetëse për flukset kombëtare dhe ndërkombëtare të njerëzve, mallrave dhe energjisë;

II. Qendër zhvillimi ekonomik tërheqës për investimet vendase dhe të huaja;

III. Qendër urbane policentrike e pjesshme që do të ofrojë shërbime cilësore ndaj qytetarëve të saj, dhe të vizitorëve;

Politikat Strategjike;

- Objektivi Strategjik 1: Turizëm i Qëndrueshëm. Lezha, hapësirë me potenciale turistike, vlera bujqësore, natyrore dhe kulturore.

- Objektivi Strategjik 2: Industria Agro-Ushqimore. Lezha, pol bujqësor, atraktive për investitorët strategjikë në fushën e industrisë agro-ushqimore.
- Objektivi Strategjik 3: Facilitete dhe Shërbime. Lezha për qytetarët, ku do të ofrojë facilitete dhe shërbime eficiente, cilësore dhe gjithëpërfshirëse.

Bazuar në këtë kuadër planifikimi, shpërndarja e burimeve është adresuar drejt politikave dhe qëllimeve të zhvillimit strategjik, të cilat orientojnë ;

- Ndërtimin e një strukture urbane optimale që merr parasysh vendndodhjen dhe zhvillimin e poleve urbane, densitetin e sipërfaqes së ndërtuar, sipërfaqeve të hapura e jeshile, dhe sistemet e transportit, etj;

- Përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe barazisë sociale për banorët e saj të fokusuar në gamën e shërbimeve dhe të mirave materiale që i ofron ambienti qytetarëve si dhe mundësitë e aksesit të qytetarëve në to. Këtu mund të përmendim punësimin, shëndetin, arsimimin, kulturën, mbrojtjen sociale, shërbimet e tjera për qytetarët dhe vizitorët e qyteteve.

Bashkia Lezhë përbëhet nga 10 njësi administrative. Ka 2 qytete, Lezhën dhe Shëngjninin, si dhe 65 fshatra. Ajo gjendet në veriperëndim të vendit dhe kufizohet në veri me Bashkitë Shkodër e Vau-Dejës, në lindje me Bashkinë Mirditë, në jug me Bashkinë Kurbin dhe në përendim me detin Adriatik. Ka një sipërfaqe prej 456.8km<sup>2</sup>, ku rreth 65 % e saj është kodrinore e malore dhe 35 % e sipërfaqes është fushore.

Popullsia sipas gjendjes civile është 108,519 banorë,

ndërsa sipas Censurit është 65,633 banorë. Në qendrat urbane jetojnë rreth 40 % e popullsisë, ndërsa në zonën rurale jetojnë rreth 60 % e popullsisë. Degët bazë të ekonomisë së saj janë bujqësia, turizmi dhe tregtia. Në territorin e bashkisë zhvillojnë aktivitet pothuajse të gjitha llojet e transportit, ai rruqor, hekurudhor dhe detar. Në këtë territor ndodhet Porti Detar i Shëngjinit dhe Aeroporti Ushtarak i Gjadrit.

Bujqësia dhe Turizmi janë sektorët më prioritarë të zhvillimit, krahas sektorëve të tjerë si peshkimi, industria e përpunimit të drurit, materialeve të ndërtimit, tregëtisë dhe të shërbimeve.

Turizmi, krahas bujqësisë është një nga sektorët më në rritje e zhvillim, kryesisht ai bregdetar, i cili zhvillohet në një vijë bregdetare prej 38 km. Krahas këtij turizmi një burim asetesh turistike janë edhe trashëgimia arkeologjike, etno-kulturore, historike dhe burimet e tjera natyrore dhe të traditës.

Përgatitja e PBA-së për vitet 2018-2020 u mbështet kryesisht në:

- Analizën e të ardhurave dhe të shpenzimeve për dy vitet e fundit, viti 2016 dhe i pritshmi i vitit 2017.
- Parashikimin e burimeve financiare për periudhën 2018-2020;
- Përcaktimin e taveve sipas çdo programi dhe funksioni (për tre vitet e ardhshme);
- Përzgjedhjen e prioriteteve të investimeve sipas fushave/programeve, duke u bazuar në strategjinë e zhvillimit të territorit.

- Analizën dhe vlerësimin e projekteve, dhe lidhjen e tyre me Strategjinë e Zhvillimit dhe Planin e Përgjithshëm Vendor;
- Analizën e kontratave të shërbimeve publike, të shpenzimeve të mirëmbajtjes së objekteve arsimore e shëndetësore, të rrugëve të urbane dhe rurale;

Për periudhën fillestare të planifikimit, pas reformës administrative territoriale, ka qenë e vështirë mbledhja dhe analizimi i të gjitha të dhënave për planifikimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve si rezultat i mungesës së tyre.

Formulimi dhe prezantimi i buxhetit për vitet 2018-2020 është bërë duke zbatuar me korrektësi kërkesat e ligjit nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave, të orientuar drejt produktit në shërbime dhe mirëqenie për banorët e bashkisë.

Planifikimi i buxhetit është bërë referuar në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit, e pikërisht, qëllimet dhe objektivat strategjike të saj, drejt objektivave të programit, dhe të treguesve të produkteve, aktiviteteve dhe koston për periudhën e planifikimit.

Metodologjia e planifikimit e përdorur sipas skemës së mëposhtme, e bën këtë buxhet të lexueshëm dhe të monitorueshëm lehtësisht në çdo kohë, gjatë gjithë procesit të zbatimit, nga çdokush; nga administrata vendore, nga këshilltarët vendore, nga organizatat dhe shoqëria civile. Bashkia mbi bazën e funksioneve dhe fushave të përcaktuara në ligjin nr.139/2015, dhe që janë përgjegjësi e bashkisë ka miratuar 14 programe buxhetimi.

# Dëgjese publike për projekt buxhetin e vitit 2018

Është prezantuar projektbuxheti i Bashkisë Lezhë për vitin 2018 si dhe plani i shpenzimeve sipas programeve dhe strukturës ekonomike për periudhën 2018-2020. Qytetarët po bëhen gjithnjë e më aktiv në diskutimin e vendimmarrjeve të cilat sjellin ndikim të drejtpërdrejtë në interesat e tyre. Në këtë dëgjese publike merrnin pjesë qytetarë të Lezhës, intelektualë, drejtues të Dhomës së Tregtisë, biznesmenë,

grupe të tjera interesi, media, shoqata e organizata të ndryshme. Kryetari i Bashkisë Lezhë, zoti Fran Frrokaj, u ndal tek prioritetet kryesore të investimeve duke treguar transparencë para pjesëmarrësve për pyetje, sugjerime dhe diskutime. Ndërkohë, drejtorët e drejtorive të bashkisë bënë një panoramim të shkurtër për planin e shpenzimeve sipas programeve dhe strukturës ekonomike për periudhën 2018-2020.

Tabela e mëposhtme adreson fondet për çdo program për vitet 2018-2020

mijë/lek

	Programet buxhetore	Plan 2018	Plan 2019	Plan 2020
P1	Planifikim Manaxhim Administrim	335,492	285,566	292,400
P.2	Shërbimi i Kujdesit Parësor	0,0	0,0	0,0
P3.	Mbrojtja dhe Siguria Publike	43,244	44,165	44,872
P4.	Emërgjencat Civile	11,928	11,606	11,690
P.5	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	8,400	10,000	10,000
P.6	Shërbimet Publike Vendore	211,810	149,859	154,230
P.7	Arsimi	260,478	192,670	196,432
P.8	Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	27,857	26,126	26,649
P.9	Infrastruktura dhe Transporti Rrugor	135,905	354,637	383,170
P.10	Edukimi dhe Sporti	9,330	6,972	6,972
P.11	Arti, Kultura dhe Turizmi	48,795	27,504	27,792
P.12	Mbrojtja e Mjedisit dhe Menaxhimi i Pyjeve	17,868	13,227	13,492
P.13	Planifikimi Urban	0,0	0,0	0,0
P.14	Shërbimi Social dhe Strehimi	31,876	7,836	7,836
	Fondi rezervë	5,000	5,000	5,000
	Fondi i Kontigjencës	5,000	5,000	5,000
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>1,152,983</b>	<b>1,140,168</b>	<b>1,185,535</b>



# Mblidhet Këshilli Bashkiak i Lezhës

Nën drejtimin e kryetarit Kristian Gjiodaj, është mbledhur Këshilli Bashkiak i Lezhës, i cili me shumicë votash shqyrtoi dhe miratoi një sërë projektvendimesh që kishin të bënin me marrëveshje bashkëpunimi të bashkisë me organizata të ndryshme, dhënien e ndihmës ekonomike personave me aftësi të kufizuar, përdorimi i fondit rezervë për dhënie të ndihmës financiare, përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ZRPP, si dhe shqyrtimi e miratimi i projektvendimit për disa ndryshime të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 166, datë 10.07.2017, që lidhen me miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetit të Bashkisë Lezhë për vitin 2017. Ndërkohë, miratimi i kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit nga bashkia dhe rishqyrtimi e miratimi i projektvendimit nr 7443 për kalimin e tokës bujqësore nga përdorim në pronësi të përfituesve ishin pika të tjera të rendit të ditës së kësaj mbledhjeje. Anëtarët e Këshillit Bashkiak, diskutuan me drejtues dhe specialistë të drejtorive pranë Bashkisë Lezhë dhe argumentuan hollësisht për gjithë çfarë u parashtrua aty, duke u dhënë zgjidhje problemeve të ngritura.



# Mblidhet Shtabi i Përgjithshëm i Emergjencave Civile

Me datë 11/12/2017 në ambientet e Bibliotekës së Lezhës u organizua takimi i Shtabit të Emergjencës me pjesëmarrjen e Prefektit të Lezhës z.Gjergj Prendi, Nënkryetarit të Bashkisë Lezhë z.Enver Hafizi si dhe Drejtorive Rajonale dhe përfaqësues të Bashkisë Lezhë. Takimi u realizua në kuadër të masave parandaluese që Bashkia Lezhë dhe shtabi i emergjencave po merr mbi parandalimin e situatave të emergjencave civile në Bashkinë e Lezhës. U vu theksi në bashkëpunimin dhe informimin e shtabit të emergjencave nga institucionet përkatëse si dhe transparencës në shpërndarjen e ndihmave për familjet në nevojë. Drejtoritë e Bashkisë Lezhë dhe Drejtoritë Rajonale angazhohen bashkë me stafet e tyre për të marre masat paraprake në funksion të parandalimit të çdo situatë.



# Përrurohet Shkolla e mesme e bashkuar "Gjovalin Gjadri" Gjadër

Përrurimi i përfundimit të punimeve për rikonstrukcionin e shkollës së mesme të bashkuar "Gjovalin Gjadri", në fshatin Gjadër të Njesisë Administrative Dajç, përkoi me 50-vjetorin e krijimit të saj. Ky projekt i Bashkisë Lezhë, me vlerë 18 milion lekë u shpall fitues nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Punimet për rikonstrukcionin e plotë të kësaj shkolle u kryen me cilësi dhe sot objekti ka tjetër pamje. Klasat dhe kabinetet mësimore përformojnë një standart bashkëkohor të shkollave të avancuara europiane. Në ceremoninë përruruese, zëvendëskryetarja e Bashkisë Lezhë, Alfrida Marku, theksoi se nëse duam të kontribuojmë në zhvillimin e shoqërisë sonë duhet të investojmë në dije dhe të këmbëngulim në edukimin dhe arsimimin e brezit të ri. Investimet e duhura infrastrukturore në

objekte shkollore dhe pajisje, mirëmbajtja e tyre si dhe korrektësia e profesionalizmi i stafeve pedagogjike, pa diskutim që ndikojnë në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Drejtori Hasan Muça u ndal tek rruga 50-vjeçare e kësaj shkolle në arsimimin e edukimin e shumë brezave. Ai adresoi respekt e mirënjohje për gjithë mësuesit që kanë shërbyer në këtë shkollë. Ndërsa, drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit, Bardhok Pulaj, evidentoi rëndësinë e investimit në shkolla dhe njëhërësh bashkëpunimin e stafit pedagogjik të shkollës së Gjadrit me prindërit, pa të cilin nuk mund të realizohet procesi i edukimit dhe të nxënësve. Të pranishmit vizituan mjediset e kësaj shkolle të rikonstruktuar, që plotëson më së miri gjithë standartet e kërkuara për një proces mesimor normal.



# BASHKIA LEZHË VLERËSOHET ME ÇMIMIN E PARË PËR PRAKTIKËN MË TË MIRË

Për të dytin vit radhazi, Bashkia Lezhë vlerësohet me çmimin e parë për praktikën më të mirë, në konkursin kombëtar të zhvilluar nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor, duke përfituar një mbështetje financiare për aktivitetet kulturore me përparësi fëmijët dhe edukimin e tyre. Pas Bibliotekës Lëvizëse, edhe Qendra Kulturore e Fëmijëve Lezhë me temën "Traditë dhe risi" është u vlerësua nga juria si rast suksesi për risite që ka sjell për publikun lezhjan dhe me gjere ku mund të permendim:

Risjellja në skenën, pas 30 vitesh, në një mjedis e mentalitet të ri, për herë të parë i teatrit 3planësh për fëmijë. Shfaqja "MENDO PËR SHENDETIN TËND" e realizuar nga Qendra Kulturore e Fëmijëve "Gjergj Laca" në Bashkinë Lezhë që u prezantua në Ditën Botërore të Shëndetit Mendor. Festivali i femijeve pas 25 vitesh në një formë të re artistike, apo krijimi i bandës muzikore për herë të parë dhe grupit folklorik si dhe organizimi i aktiviteteve me rastin e festave kombetare fetare në një formë shumë të veçantë artistike dhe shpirtërore, duke theksuar harmoninë fetare që është në këtë qytet. Përcjellja e kulturës nga një qytet në tjetrit, si edhe edhe realizimi i shfaqjeve teatrale në trevat shqiptare ka qenë

një risi për QKF-në.

Konkursi Kombëtar i Praktikave të Mira të Bashkive për vitin 2017 u mbajt me datën 6 dhjetor 2017 me koordinimin e 4 Agjensive për Zhvillim Rajonal (AZHR). Konkursi synon evidentimin e praktikave të mira të Bashkive, si përgjigje ndaj sfidave të Reformës Administrative Territoriale dhe decentralizimit. Konkursi u zhvillua në tre grupe paralele të ndara sipas kategorive: Inovacion, Shërbime dhe Zhvillim Ekonomik. Në secilin grup konkuruan 4 Bashki që u vlerësuan nga juri të përbëra nga përfaqësues të institucioneve qendrore, shoqata të autoriteteve vendore, programeve të ndryshme të zhvillimit dhe aktore që kanë ndikim në qeverisjen vendore. Pas vlerësimit nga jurite, u bë dhenia e çmimeve për fituesit e Konkursit Kombëtar të Praktikave të Mira 2017 për bashkitë: Vau Dejës në kategorinë e Shërbimeve, Korçë e Vlorë në kategorinë e Inovacionit, Sarandë e Lezhë në kategorinë e zhvillimit ekonomik. Pjesëmarrës në ceremoninë e dhenies së çmimeve ishin Zëvendës kryeministria Senida Mesi, Ambasadori i Zvicrës në Shqipëri, Christoph Graf, drejtuesit e programit DLDP dhe Agjensive Rajonale për Zhvillimit, Kryetar dhe stafet e Bashkive Pjesëmarrëse në konkurs.



## Qendra e zhvillimit ditor të fëmijëve me aftësi ndryshe, në vëmendjen e Bashkisë

Me rastin e festave të fundvitit, në ambientet e reja të Qendrës së Zhvillimit Ditor Lezhë, është organizuar një aktivitet me fëmijët me aftësi ndryshe. Ky aktivitet, organizuar nga Bashkia Lezhë, krahas koncertit festiv të shkollës “Besëlidhja”, në fokusin e tij kishte shtimin e vëmendjes dhe të përkujdesjes në krijimin e kushteve sa më normale për fëmijët me aftësi ndryshe. Zëvendeskryetarja e Bashkisë Lezhë, Alfrida Marku, duke ju uruar fëmijëve një vit sa më të mbarë, ka folur për masat që ka marrë bashkia në krijimin e kushteve sa më të mira të trajtimit të këtyre fëmijëve, për të qënë sa më efektive në integrimin e tyre në shoqëri. Ndërrimi i ambienteve në një qendër të re ka ndikuar pozitivisht në rritjen e rezultateve në procesin mësimor edukativ të fëmijëve. Duke ju uruar fëmijëve një vit sa më të mbarë, Ministrija e Arsimit Lindita Nikolla, e pranishme në këtë aktivitet, u ka premtuar se ata gjithnjë do të jenë në vëmendjen dikasterit që ajo drejton, për të ndihmuar me forma, modele e praktika të reja integrimin aktiv të këtyre fëmijëve në shoqëri. Ka përshëndetur në këtë aktivitet edhe zëvendesministrija e Shëndetësisë, Ardiana Jaku. Fëmijëve me aftësi ndryshe ju shpërndane dhurata të mbledhura me kontributin financiar të bashkisë dhe disa bizneseve të Lezhës.



## Bashkia dhe shkolla “Akademik Center” shpërndajnë ndihma për familjet në nevojë



Bashkia Lezhë në bashkëpunim me “Lezha Akademik Center” dhe me mbështetjen e deputetes znj.Lindita Metaliaj dhuruan disa pako për familjet më në nevojë, kjo më shumë si formë urimi me rastin e festave të fundvitit. Ashtu si dhe vitin e kaluar, Bashkia Lezhë në koordinim me Kishën Katolike në Torovicë përzgjedhën familjet me problemet më të mprehta nga kjo zonë. Deputetja e Lezhës Lindita Metaliaj i bëri thirrje organizatave, shoqatave dhe biznesmenëve të ndryshëm që t’iu vijnë në ndihmë këtyre shtresave dhe solidarizimi i shoqërisë duhet të jetë gjithnjë dhe më i lartë. Metaliaj në mënyrë të veçantë i bëri thirrje qeverisë që të kthejë vëmendjen në Torovicë si një ndër zonat më varfërinë më të madhe në Lezhë për shkak të mungesës së investimeve. Familjarët që tërhoqën pakot me ndihma shprehën mirënjohje për Bashkinë Lezhë, shkollën “Lezha akademik Center” dhe deputeten znj. Lindita Metaliaj.



## Fund dhunës ndaj grave dhe vajzave

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave, Bashkia Lezhë në bashkëpunim me Shoqatën e Grave me probleme sociale dhe institucione të tjera, organizuan një takim i cili u shoqërua me një marshim sensibilizues në rrugët e qytetit, duke përcjellë mesazhin: “Fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”. Drejtues të Bashkisë, institucioneve dhe shoqatave, theksuan se mbrojtja e të drejtave të grave e vajzave dhe parandalimi i dhunës ndaj tyre është mision dhe detyrë e çdo burri, të riu, i organeve kompetente dhe gjithë shoqërisë tonë. Rastet e hasura të dhunës, u shpreh zëvendëskryetarja e Bashkisë Lezhë, Alfrida Marku, tregojnë se ende ka shumë punë për të bërë në këtë drejtim. Shërbimet Sociale pranë bashkisë, po e vlerësojnë me përparësi këtë fenomen, duke ofruar mbështetje e ndihmë të specializuar për rastet që shfaqen. Prefekti i Lezhës Gjergj Prendi evidentoi faktin se shteti shqiptar e ka sanksionuar me ligj mbrojtjen nga dhuna të grave dhe vajzave, duke patur për qëllim parandalimin, reduktimin e këtij fenomeni aq të dëmshëm për familjen dhe shoqërinë tonë. Në këtë takim dhanë mesazhet e tyre të mbrojtjes nga dhuna edhe folës të tjerë, përfaqësues të shoqatave dhe institucioneve. Në fund u bë marshimi sensibilizues ku, krahas pjesëmarrësve që mbanin në duar shkrimin “Fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”, pedatuan me biçikleta në rrugët kryesore të qytetit edhe një grup të rinjsh.



## Bashkia Lezhë një ndër 5 bashkitë ku do zbatohet projekti “shërbime të integruara sociale”

Lezha do të jetë një ndër 5 bashkitë e përzgjedhura ku do të zbatohet projekti “Shërbime të integruara sociale për një zhvillim social dhe ekonomik të qëndrueshëm për individët pjesë e shtresave në nevojë”. Ky projekt është pjesë e programit “Leave No One Behind”, i financuar nga Kombet e Bashkuara dhe që do të zbatohet nga Fondacioni Ndihmë për Fëmijët”, për një periudhë 4 vjeçare. Qëllimi i këtij projekti do të jetë: asistencë mësimore dhe përfshirja sociale për fëmijët dhe paralelisht shërbime sociale për familjet, ngritja e kapaciteteve individuale, formimi profesional si dhe mbështetja nga skema e gjenerimit të të ardhurave për familjet. Edukimi duhet të jetë baza e çdo ndryshimi pozitiv.

## Një pemë më shumë-mjedis më i pastër dhe i shëndetshëm.

Në kuadër të muajit dhjetor, dedikuar pyjeve, Agjencia e Administrimit të Pyjeve pranë Bashkisë Lezhë, ka filluar nismën “Me dy duar”, për mbjelljen e fidanëve pyjorë në të gjitha njësitë administrative. Fillimisht kjo nismë u ndërmor në oborrin e shkollës së mesme të bashkuar “Pjetër Zarishi” në Njësinë Administrative Blinisht, bashkë me nxënës e mësues të kësaj shkolle si dhe përfaqësues të njësisë administrative. Kjo inisiativë vazhdoi edhe me mbjelljen e 30 fidanë rrapu dhe 40 fidanë pishe përgjatë rrugës kryesore të këtij fshati nga stafi i Njësisë Administrative Blinisht, si vazhdim i aktivitetit të zhvilluar në shkollë. Të gjithë bashkë, qytetare dhe përfaqësues të institucioneve, duhet të ndërgjegjësohemi që të bëjmë maksimumin për ruajtjen dhe përmirësimin e parametrevë mjedisore. Stafi i Njësisë Administrative Blinisht përcolli kështu mesazhin për një mjedis sa më të pastër, pasi një pemë e mbjellë sot sjell një mjedis më të pastër, më të bukur dhe shëndetshëm nesër. Bashkia Lezhë do të shtrijë në gjithë territorin e saj këtë praktikë për të ndikuar në përmirësimin e ajrit, shmangien e erozionit dhe përmytjeve, si dhe për të krijuar një ambient sa më të këndshëm që ndikon në përmirësimin e perceptimit të ambientit edhe nga qytetarët.






# Bashkia Lezhë organizon koncert festiv në prag të Vitit të Ri

Artistë të njohur të skenës kanë dhuruar emocione të shumta për publikun lezhjan në koncertin “Të festojmë së bashku”, organizuar nga Bashkia Lezhë në kuadër të festave të fundvitit. Në koncertin live interpretuan këngëtarët: Albana Përvathi, Zef Beka, Gent Deda, Arben Gjeloşi, Ardit Çuni, Greta Kapcari dhe grupi i valleve. Humori brilant i aktores “Aja”, i dha edhe më gjallëri këtij aktiviteti që mori duartrokitjet e shumta të publikut. Kryebashkiaku Fran Frrokaj uroi të gjithë banorët e Lezhës, për sa më shumë harmoni, mirëqenie, paqe dhe solidaritet në këtë prag të ndërrimit të viteve, ndërsa premtoi më shumë vemendje ndaj artit dhe kulturës. Koncerti vijoi me numra koreografik, këngë dhe pjesë të tjera muzikore.



# Futbollistit Nikolin Lorenci i akordohet titulli: “Qytetar Nderi i Lezhës”

Me propozim të kryetarit të Bashkisë Lezhë, z.Fran Frrokaj, Këshilli i Bashkisë Lezhë me Vendimin nr.218 datë 04.12.2017, ka vlerësuar z.Nikolin Lorenci me titullin ‘Qytetar nderi’ me motivacionin “Për kontributin e jashtëzakonshëm në fushën e futbollit lezhjan, gjithashtu edukimin dhe trajnimin e brezave ndër vite”. Me këtë rast Frrokaj ka pritur Nikolin Lorencin i cili shoqërohej nga shokë e të afërm dhe një grup sportistësh, gazetarësh e simpatizues të sportit lezhjan. Duke i dorëzuar titullin e nderit, kreu i Bashkisë evidentoj kontributin e Nikolin Lorencit si futbollist i Besëlidhjes, mësues i edukimit fizik dhe trajner. Me të njëjtin vlerësim për këtë figurë të nderuar të sportit lezhjan u shpreh dhe kryetari i Këshillit Bashkiak Kristian Gjidodaj. Duke marrë këtë titull, Lorenci u shpreh mirënjohje zotit Frrokaj dhe Këshillit Bashkiak për nderin dhe vlerësimin që i bëjnë. Ndërkohë, gazetarë dhe ish futbollistë të Besëlidhjes shprehën me nota pozitive konsideratat e tyre superiore për Lorencin, i cili si futbollist bëri shumë emër në fushat e blerta të stadiumeve tona . Nikolin Lorenci është një ndër kontribuesit më të spikatur në fushën e arsimit dhe të sportit lezhjan, dhe një ndër protagonistët për lartësimin e futbollit nën emrin “Besëlidhja”. Gjithashtu, pjesëmarrës në futbollin elitare, kombëtar, trajner e drejtues, aktualisht i angazhuar pranë FSHF-së .



# THIRRJE PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIMEVE DREJTUAR ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

BASHKIA LEZHË NË PARTNERITET ME PROGRAMIN ReLOaD SHPALL: THIRRJE PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR DORËZIMIN E PROJEKT PROPOZIMEVE NË PROGRAMIN RAJONAL PËR DEMOKRACINË LOKALE NË BALLKANIN PERËNDIMOR (ReLOaD) Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) financohet nga Bashkimi Europian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë. Qëllimi i përgjithshëm i programit ReLOaD është që të fuqizojë demokracitë pjesëmarrëse dhe procesin e integritetit në BE në Ballkanin Perëndimor, duke e fuqizuar shoqërinë civile që të jetë pjesë e proceseve të vendimmarrjes si dhe duke kontribuar dhe mundësuar një mjedis ligjor dhe financiar inkurajues për shoqërinë civile.

Qëllimi specifik i këtij programi është fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet njësive të pushtetit lokal dhe shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor, duke inkurajuar zbatimin e modelit të suksesshëm të realizuar në Bosnje dhe Hercegovinë lidhur me financimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) nga buxheti i pushtetit lokal në përpunje me prioritetet lokale.

Programi ReLOaD do të promovojë sinergji ndërmjet njësive të pushtetit lokal dhe OSHC-ve duke kontribuar në rritjen e cilësisë së jetesës në rreth 50 njësi të pushtetit vendor në gjithë Ballkanin Perëndimor të cilat priten të përfshihen dhe të kenë përfitime direkt në procese vendimmarrëse, gjithëpërfshirëse dhe transparente. Programi do të zbatohet për një periudhë 36 mujore.

ReLOaD në Shqipëri pritet të zbatohet rreth 50 projekte të OSHC-ve në 12 bashkitë partnere dhe të ofrojë shërbime të përmirësuara dhe të shumëllojshme për qytetarët që marrin shërbime në këto bashki.

Bashkia Lezhë dhe programi ReLOaD fton të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) në Shqipëri që të paraqesin projekt-propozime që janë në përputhje me objektivat zhvillimore të Bashkisë Lezhë dhe janë në përputhje me prioritetet e përcaktuara më poshtë:

1. Përfshirja sociale dhe mbrojtja e grupeve të marginalizuara,
2. Zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit duke përfshirë turizmin;
3. Fuqizimi ekonomik i grave dhe integrimi i të rinjve duke përfshirë aktivitetet sportive.

Shuma e fondeve për projektet e miratuara do të jetë prej 650.000 Lek deri 4.500.000 Lek.

OSHC-të lejohen që të dorëzojnë më shumë se një projekt propozim për aq kohë sa shuma e përgjithshme e ndarë nuk kalon shumën prej 8.000.000 Lek gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit ReLOaD (deri në janar 2020). Bashkia rezervon të drejtën që të mos i alokojë të gjitha fondet që ka në dispozicion në rast se projekt-propozimet e paraqitura nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara. Kohëzgjatja e secilit projekt mund të shkojë nga 6 deri në 12 muaj. Projektet e përzgjedhura duhet të zbatohen në periudhën nga Prill/2018 deri në Prill/2019.

## PËRSHTATSHMËRIA/PRANUESHMËRIA:

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur në baza të barabarta për të gjitha OSHC-të e regjistruara zyrtarisht (shoqata/organizata apo fondacion) në përputhje me ligjet dhe rregulloret e në fuqi në Shqipëri. Të gjitha organizatat e shoqërisë civile të interesuara mund të gje-

jnë informata të hollësishme rreth kushteve për aplikim si dhe për kriteret për financimin e projekteve në Udhezimin për Aplikant, që është pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes publike.

## DOKUMENTACIONI:

Dokumentacioni i aplikimit për thirrjen publike të Bashkisë Lezhë do të jetë i disponueshëm nga 08/01/2018, pas dërgimit të një kërkesë me e-mail në adresën pzhvillimi@lezha.gov.al, ku duhet ta citoni emrin e organizatës së interesuar, ose duke u paraqitur personalisht në zyrën:

Bashkia Lezhë  
Drejtoria e Integritetit Europian dhe Programeve të Zhvillimit,  
Rruga Frang Bardhi, (Përballë Prefekturës)  
4501, Lezhë

Të gjitha informacionet e nevojshme, si dhe një version elektronik i paketës së aplikimit mund të gjendet edhe në web-faqen zyrtare të Bashkisë (www.lezha.gov.al) si dhe në web-faqen e UNDP (www.al.undp.org).

Sesionet informuese (ditët e hapura) lidhur me këtë ftesë me OSHC-të e interesuara për të aplikuar do të mbahen në Bashkinë Lezhë me datën 22/01/2018 në ora 11:00 në ambientet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve.

Pyetje rreth ftesës publike mund të behën përmes e-mail adresës registry.al@undp.org, duke iu referuar thirrjes publike. Pyetjet mund të dërgohen deri me 05/02/2018, ndërsa përgjigjet do të jepen me shkrim brenda 3 ditëve pune që nga data e pranimit të pyetjeve përkatëse. Për qëllime transparence, përgjigjet do t'u dërgohen gjithashtu të gjithë aplikantëve të mundshëm, ose do të botohen në faqen e internetit të bashkisë dhe/ose UNDP.

## DORËZIMI I APLIKIMEVE:

Aplikimet e plotësuara (me të gjithë dokumentet



Empowered lives.  
Resilient nations.

mbështetëse) duhet të dorëzohen në tri (3) kopje të shtypura dhe një kopje elektronike (CD apo USB), të vendosura në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar referenca e thirrjes publike, përmes postës zyrtare apo personalisht, gjatë ditëve të punës (e hëne – e premte), nga ora 09:00 deri ora 15:00, në adresat në vijim:  
Bashkia Lezhë

Zyra e Protokollit, Kati I  
Sheshi "Gjergj Kastrioti"  
4501, Lezhë

Afati për dorëzimin e aplikimeve është data 12 /02/ 2018, ora 15:00. Aplikimet e dorëzuara pas këtij afati do të merren parasysh vetëm nëse vula postare tregon se data dhe koha e dërgimit ka qenë para mbylljes së afatit zyrtar. Pjesa e jashtme e zarfit duhet të përmbajë titullin e thirrjes për dorëzimin e propozimeve, emrin dhe adresën e plotë të kandidatit, emrin e plotë të projektit dhe mbishkrimin "Të mos hapet përpara hapjes zyrtare." Formulari për regjistrimin e dokumentacionit të pranuar lëshohet nga përfaqësuesi i bashkisë. Të gjithë aplikantët që kanë paraqitur propozime, pavarësisht nëse pranohen ose jo, njoftohen me shkrim për vendimin e marrë për projekt-propozimin e tyre brenda 30 ditësh nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet do të publikohen në faqen e internetit të bashkisë (www.lezha.gov.al), në tabelën e njoftimeve të bashkisë, dhe në web-faqen e UNDP-së (www.al.undp.org).



Bashkia Lezhë,  
Lagjia Skënderbeg,  
Sheshi "Gjergj Kastrioti",  
4501, Lezhë,  
info@lezha.gov.al  
www.lezha.gov.al